

**URDHËR**  
**Nr. 25, datë 13.2.2025**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1054, datë 22.10.2010, “Për miratimin e rregullores mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin e ofiçinave të tahografëve analogë dhe digjitalë në transportin rrugor, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1054, datë 22.10.2010, “Për miratimin e rregullores mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli.

2. Në ushtrimin e kompetencës së deleguar, z. Ami Kozeli, ndjek dhe zbaton procedurat dhe rregullat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1054, datë 22.10.2010, “Për miratimin e rregullores mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”.

3. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 51, datë 5.3.2024, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Belinda Balluku**